



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Lidhur me datë 28.05.2021 në mes të:

1. Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës në tekstin vijues Komuna;
2. OJQ "Mural Fest Kosova" të cilën e përfaqëson Lebibe Topalli, Drejtoreshë Ekzekutive, në tekstin vijues "Mural Fest Kosova"

Neni 1

Qëllimi

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të rinjve të Komunës së Gjakovës dhe përfshirjen e të gjithë krijuesve që për mes aktiviteteve të ndikojnë në rritjen e vetëdijes qytetare përmes punëve artistike që zhvillon OJQ "Mural Fest Kosova"

Neni 2

Obligimet e Komunës

- 2.1. Komuna ka për obligim mbulimin e një pjese të shpenzimeve nga kategoria mallra dhe shërbime nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit të ndara në këto kategori:
 - Sigurimin e kraneve lëvizës apo skelave në vlerë prej 4,700.00€,
 - Transportin e pjesëmarrësve në vlerë prej 400.00€,
 - Sigurimin e ngjyrave për murale në vlerë prej 5,000.00€,
 - Si dhe materiale tjera në vlerë prej 700.00€
- 2.2. Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport do të bëjë përcjelljen e aktiviteteve me qëllim të mbarëvajtjes së punëve.

Neni 3

Obligimet e "Mural Fest"

- 3.1. Obligohet që të gjitha aktivitetet të kryen në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe me drejtoritë tjera relevante.



3.2. Për të gjitha shpenzimet e bëra për realizimin e projektit të linjave të financuara nga Komuna e Gjakovës të sjellin raport-faturat e shpenzimeve.

Neni 4

Ky Memorandum Bashkëpunimi është përpiluar në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilave nga 2 (dy) i dorëzohen palëve nënshkruese.


Neni 5

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve, të cilat zotohen se të njëjtin do t'a zbatojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.


Dokumenti hyn në fuqi pas momentit të nënshkrimit nga palët nënshkruese.

PALËT

Komuna e Gjakovës


Ardian Gjini
31/05/2021


OJQ "Mural Fest Kosova"


Lebibe Topalli


28 / 05 / 2021